FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION
Shtëpia e Sporteve, rr. Ramiz Sadiku Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com

Bazuar në nenin 16 paragrafi 2.4. si dhe nenin 26 të Statutit si dhe nenin 7 të Rregullores mbi punën e Përfaqësueses së Kosovës, Bordi Ekzekutiv i FPPK-së në mbledhjen e datës 11.02.2025 nxori Vendim që të publikoi këtë:

# KONKURS

## Drejtor i Përfaqësueses së Kosovës në Pingpong

**KUSHTET**

Një person për t'u emëruar Drejtor i Perfaqesueses duhet të plotësoj këto kushte:

1. të jetë veprimtar i dalluar i sportit të pingpongut me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
2. të ketë përvojë si drejtues sportiv ose trajner përgjatë karrierës; të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike, ose i certifikuar në njërin nga nivelet formale të ITTF për trajner;
3. të njeh një gjuhë botërore, përparësi i jepet gjuhës angleze;
4. aftësi organizuese në planifikimin, menaxhimin dhe organizimin e grumbullimeve dhe garave;
5. të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe të menaxhoj situata të papritura;
6. të ketë aftësi të komunikimit verbal dhe të shkruar si dhe aftësi të motivimit të ekipit të përbërë nga sportistë e trajner;
7. të jetë i disponueshëm dhe fleksibil për angazhim të plotë duke përfshirë mundësinë e udhëtimeve dhe grumbullimeve intensive;
8. të ketë sportist të dalluar dhe që kanë rezultate të dëshmuara;
9. të mos ketë rënë në kundërshtim me zbatimin e normave të meritokracisë përgjatë karrierës së tij/saj; apo të ketë marrë vendime arbitrare.
10. mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartës Olimpike dhe të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

**Përshkrimi i detyrave të Drejtorit të Përfaqësueses, përpilon:**

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së përfaqësueses,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të përfaqësueses,
- Propozimin e kalendarit të garave të përfaqësuesespër sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të suksesshme të përfaqësueses në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për përfaqësuesen për vitin e ardhshëm.

**MANDATI**

- 4 vjecar me mundesi te rizgjedhjes edhe per nje mandat,
- kontrata do të bazohet në pagese fikse mujore dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të tjera për aktivitetet e kryera.

**AFATI I PARAQITJES**

Afati i aplikimit është nga data **18.02.2025 deri me 28.02.2025.**

Aplikacioni i kompletuar duhet të përmbajë

- Cv
- Diploma universitare ose Certifikata për kryerjen e Nivelit I apo II për trajner ndërkombtar
- Dëshmi për punën aktive si trajner, perfshirë numrin e sportistëve sipas grupmoshave
- Dëshmi për rezultate e arritura individuale dhe ekipore si në gara individuale dhe ekipore në arenën vendore dhe ndërkombetare
- Dëshmi nga gjykata që nuk është i denuar me vendim të formës së prerë.
- Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze
- Një përmbledhje të programit te punes 1 dhe 4 vjeçare për punën me përfaqësuesen dhe ngritjen e cilësisë

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dërgohen në email adresen: **sg@fppk.com** ose të shtypura në Zyren e FPPK-se..